

Objekti i veprimtarisë së kësaj Drejtorie është shërbimi ndaj subjekteve fizike dhe juridike, shtetërore dhe private, në veprimtarinë e transportit rrugor për:

- Regjistrimi i mjeteve (pajisjen e tyre me targa dhe leje qarkullimi, regjistrimin e pronarëve të tyre dhe pajisjen me certifikate pronësie).
- Lëshimi i kartë memorie tahografi dixhital.
- Lëshimi i Çertifikatës ATP për mjetet izotermike.
- Lëshimi i Çertifikatës për Transport Ndërkombëtar Mallrash për të Tretë dhe me Qera.
- Lëshimi i Çertifikatës së kontrollit teknik CEMT.
- Lëshimi i Çertifikatës së miratimit ADR për mjetet që transportojnë lëndë të rrezikshme.
- Liçensimi për transport të mallrave jashtë norme.
- Monitorimi i kualifikimit të drejtuesve të mjeteve rrugore dhe pajisja e tyre me lejedrejtimi, rinovimi, rimarrja dhe konvertimi i lejedrejtitimit.
- Kontrolli i veprimtarisë së autoshkollave.
- Krijimi i regjistrit kombëtar të mjeteve dhe drejtuesve të tyre (transmetimi i menjëhershëm i të dhënave që kërkohen nga organet e përcaktuara me ligj).
- Organizimi, shtypja dhe shpërndarja e dokumentacionit bazë për transportin rrugor.
- Kryerja e veprimtarisë së agjentit tatimor, sipas përcaktimeve ligjore.
- Lëshimi i dëshmimeve të taksistëve, instruktorëve të praktikës dhe teorisë etj.
- Trajnimin e specializuar në transportin rrugor për pajisjen e aplikanteve me dëshminë e aftësisë profesionale.
- Kontrollin shtetëror të operatorëve të transportit rrugor dhe mbikqyrjen e kualifikuar gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre si dhe cdo object tjetër veprimtarie të lejuar nga legjislacioni në fuqi dhe që nuk bie në kundërshtim me aktet ligjore të cituara më sipër dhe me rregullat e përcaktuara në këtë Statut.